



KËSHILLA RRETH INFEKSIONEVE QË BARTEN NË RRUGË SEKSUALE

DET HÄR ÄR EN ÖVERSÄTTNING TILL ALBANSKA AV FAKTABLADET RÅD OCH FAKTA OM SEXUELLT ÖVERFÖRDA INFEKTIONER – HEPATIT.

Hepatiti

Hepatiti (verdhëza) është një nocion përm-bledhës i një pezmatimi në mëlçi që shkatohet nga virusë të ndryshëm. Lloje të ndryshme të hepatitit barten përmes ushqimit dhe gjilpërave të papastërta. Ca lloje të hepatiteve barten edhe në rrugë seksuale. Kjo vlen për hepatitin A dhe hepatitin B. Ngjitje seksuale ndodh edhe me hepatitin C, edhe spe është më e pazakonshme.

Hepatit përfshihet nga ligji për mbrojtje nga sëmundjet ngjitëse që do të thotë se testimi është falas nëse dyshon se je i infektuar. Të vaksinohesh kundër hepatitit A dhe B, që në mënyrë konsekuente të përdorësh kondom në rast seksi dhe të mos i ndash shiringat me të tjerët, janë strategji që mund t'i përdorësh në mënyrë që të mos infektosh.

Hepatiti A

Hepatiti A përhapet përmes ujërave të zeza që ndotin ujin e pijes dhe artikujt ushqimor në vende me mangësi saniteti. Meqenëse virusi tajitet përmes jashtëqitjes atëherë hepatiti A mund të ngjitet në rast kontakti të afërt, psh. kontaktit seksual.

Ai/ajo që infektohet mund të sëmuret pas ca javësh me temperaturë dhe tugë e pastaj vjellje si dhe zverdhim në të bardhët e syve dhe lëkurë. Edhe urina merr ngjyrën e mbylltë dhe jashtëqitja zverdhet. Simptomët dallojnë për nga forca. Një pjesë nuk e hetojnë asnjëherë se janë të infektuar ndërsa tek të tjerët lodhja dhe zvogëlimi i oreksit janë simptomët e vetme. Diagnoza përcaktohet përmes analizës së gjakut.

Nuk ka ndonjë terapi kundër hepatiti A. Infeksioni shërohet vetëvetiu plotësisht pas disa muajve. Ai/ajo që ka pasur hepatitin A një herë krijon një imunitete kundër kësaj sëmundje për tërë jetën. Ka poashtu një vaksinë efektive kundër hepatitit A.

Hepatiti B

Hepatiti B përhapet përmes gjakut të infektuar dhe gjilpërave të papastërta, psh. në rast bërjes tatu dhe abuzimit me injeksione. Një nënë e infektuar mund t'i ngjesë sëmundjen fëmijës me rastin e lindjes. Infektimi mund të bëhet përmes seksit vaginal dhe atij anal.

Simptomët janë shpesh të lehta me lodhje, dhembje nyjesh dhe oreks të dobët. Nganjëherë mund të zverdhën të bardhët e syve dhe lëkura. Mund të zgjasë deri në një gjysmë viti nga momenti i infektimit e deri te shfaqja e simptomeve. Në shumicën e rasteve ky infeksion shërohet dhe pastaj njeriu është imun gjatë tërë jetës. Tek një pjesë e vogël ky infeksion bëhet kronik. Kjo do të thotë se ngelet rreziku për t'i infektuar të tjerët përmes gjakut apo seksit. Një infeksion kronik paraqet rrezik të shtuar edhe për sëmundje pasuese siq është ceroza e mëlçisë dhe kanceri i mëlçisë. Ilaçet mund t'i frenojnë dëmtimet në mëlçi dhe në disa raste kanë edhe efekt fare shërues. Diagnoza përcaktohet përmes analizës së gjakut, e cila poashtu përdoret për të shikuar nëse infeksioni është shëruar. Ka një vaksinë efektive kundër hepatitit B.

Hepatiti C

Hepatiti C ngjitet para se gjithash përmes gjakut dhe nëse ndahen gjilpërat e papastërta në rast abuzimi me injeksione. Infektimi përmes seksit është i rrallë por ndodh sidoms në mesin e personave që e kanë edhe infeksionin e hiv-it.

Hepatiti C nuk shkaton simptome të rënda ose vetëm simptome të lehta në formë të lodhjes dhe tugut nga disa javë në disa muaj pas momentit të infektimit. Diagnoza përcaktohet përmes një analize gjaku. Një numër i madh i atyre që janë të infektuar bëhen bartës kronik të sëmundjes dhe vazhdojnë të jenë ngjitës. Me kohën ata mund të zhvillojnë cerozën e mëlqisë (mëlqia e rrudhur) e në disa raste edhe kancer mëlqie. Sot ka ilaçe efektive që në shumicën e rasteve çojnë në shërimin e këtij infeksioni. Nga ana tjetër akoma mungon një vaksinë kundër hepatitit C.

